



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 820 / Prot.

Tiranë, më 26. 5 2017

Lënda : *Kthim përgjigje në lidhje me kërkesën për interpretim*

Drejtuar: **Z. ERVIN KOÇI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

Adresa: Rruga "Dora D' Istria", nr. 10

TIRANË

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u njoh me kërkesën tuaj për interpretim, administruar me nr. 820 prot, datë 17.05.2017 "Mbi zbatimin e nenit 35 "Marrëdhëniet me shoqëritë e sigurimeve", të Ligjit nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin". Në vijim do të gjeni analizën e Zyrës së Komisionerit në kuadër të respektimit të legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Paraprakisht, vlerësojmë angazhimin tuaj në kuadër të respektimit të detyrimeve ligjore referuar Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe garantimit të mbrojtjes së të dhënave personale që përpunoni gjatë aktivitetit tuaj.

Në shkresën tuaj në lidhje me përhapjen e të dhënave sqaroni se "AMF në fund të vitit kalendarik, informon zyrtarisht Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së për listën e objekteve që janë siguruar nga zjarri të cilat mund të jenë pronë e një shtetasi, personi fizik apo juridik i cili lidh një kontratë me shoqërinë e sigurimit".

Referuar nenit 3, pika 1, e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, parashikohet: "Të dhëna personale" është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.

Në këtë kuadër, nëse lista e objekteve që janë siguruar shoqërohet me të dhëna të subjekteve tregtare (regjistruar si person fizik ose juridik në bazë të legjislacionit përkatës tregtar), këto të dhëna nuk konsiderohen si të dhëna personale dhe si të tilla nuk gëzojnë mbrojtje nga Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Në lidhje me rastin kur lista e objekteve që janë siguruar shoqërohet me të dhënat e shtetasit i cili e ka në pronësi objektin, Zyra e Komisionerit vlerëson se në lidhje me këtë përpunim të të dhënave personale, duhet pasur parasysh respektimi dhe garantimi i parimeve për mbrojtjen e të dhënave personale sanksionuar në nenin 5, të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Mbrojtja e të dhënave personale, bazohet: a) në përpunimin në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme; b) në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime; c) në mjaftueshmërinë e të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;...

Përhapja e të dhënave personale drejt subjekteve të tjera kontrolluese konsiderohet përpunim dhe përpunimi i të dhënave personale legjitimohet vetëm nëse plotësohet një nga kushtet e sanksionuara në nenin 6 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Të dhënat personale përpunohen vetëm: a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin;... ç) për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit;...

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson se, nëse AMF ka detyrimin ligjor të përpunoj/përhap të dhënat, atëherë informacioni i kërkuar mund të vihet në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së, në përputhje me parashikimet ligjore të cituara më sipër.

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI